

REPUBLICA E SHQIPËRISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË



Nr: Regj.6660 Themeltar

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ENEIDA CIVICI

asistuar nga sekretare gjyqesore **ANJEZA NERGJONI**, sot më datë **05.04.2019** mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjen civile-tregtare me **Nr. 6660 Regj. Themeltar** që i përket :

KERKUES:

ITSGA sh.a e rregjistruar në rregjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër NUIS K51313001H, me seli në adresën : Rruga e Dibrës, Pallat i ri 5- kate, kati i dytë, përbri Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tirane, Shqipëri.

OBJEKTI:

Fillimin e procedurës së falimentit për pasuritë e shoqërisë ITSGA sh.a për shkak të paaftesisë paguese.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 110/2016 dt. 27.10.2016 “Për Falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata bazuar në nenin 14, 17, 29 të ligjit Nr. 110/2016 dt. 27.10.2016 “Për Falimentimin”, i ndryshuar mori në shqyrtim në dhomë këshillimi aktet

VEREN

Se, shoqëria “ITSGA” sh.a. i është drejtuar kryesisht kësaj Gjykate, me kërkesën për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë për shkak se: *“Përmes Ligjit 75/2015 është ndaluar organizimin e basteve sportive pas datës 31 dhjetor 2018 dhe si rrjedhojë, Shoqëria e ka pasur të pamundur zhvillimin e aktivitetit tregtar përtej kësaj date. Shoqëria ka zhvilluar normalisht aktivitetin tregtar dhe ka marrë përsipër detyrime pa qenë në dijeni për ndalimin në mënyrë të papritur të aktivitetit, ndalim i cili u njoftua për publikun dhe u miratua si norme ligjore vetëm në fund të vitit 2018. Kjo ndërprerje e menjëhershme e pa paralajmërim dhe pa asnjë studim mbi efektet në aktivitetin e Shoqërisë si dhe shoqërive të tjera që veprojnë në të njëjtën fushë aktiviteti, ka shkaktuar dëme të mëdha për shoqërinë. Mjafton këtu të përmendet se përveç kreditorëve të ndryshëm Shoqëria numëronte me shume se 3,400 punëmarrës të cilëve domosdoshmërisht u janë ndërprerë ose do tu ndërpriten kontratat e punës dhe për të cilët shoqëria nuk ka pasur kohe as të ofroje afatet përkatëse të njoftimit të parashikuara nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe aq më pak të kryejë pagesat përkatëse për këto afate apo për detyrimeve të tjera kundrejt punëmarrësve, si leje të papaguara, shpërblime për vjetërsi, apo bonuse. Nga ana tjetër, Shoqëria është detyruar të mbyllë brenda më pak se një muaji një aktivitet 15 vjeçar të përberë prej më shumë se 2,450 pika/vende të ushtrimit të aktivitetit në të gjithë Republikën e Shqipërisë, çfarë automatikisht përkthehet në detyrime të shumta financiare të akumuluar prej saj. Në këto kushte shoqëria është vendosur në gjendjen e paaftesisë paguese pasi ka më shumë detyrime se sa pasuri.”*

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Ne lidhje me parashikimet ligjore ne perputhje me rastin konkret, gjykata veren se: Neni 14 i "Per falimentimin" parashikon shprehimisht se: "Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për të lehtësuar zgjidhjen dhe shlyerjen kolektive të detyrimeve të debitorit në një procedurë falimentare."

Ndersa, ne nenin 2 te tij parashikohet qëllimi i procedurës së falimentimit: "Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave."

- Shoqëria "ITSGA" sh.a. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit Tirane themeluar në datë 01.11.2003. Selia e kesaj shoqërie eshte ne Tirane Rruga «Rruga e Dibrës », pall. I ri 5-kate, kati i dytë përmbri Mendresesë, ngjitur me klinikën Ortodokse, Tiranë.
- Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e organizimit të lojrave të fatit dhe përkatësisht të basteve sportive nën emrin tregëtar «Eccobet ».
- Kapitali i shoqërisë referuar ekstraktit të QKB-së eshte ne masen 517.000.000 leke e ndare ne 51700 aksione me 10, 000 leke/aksioni.

Neni 14 i ligjit nr.110/2016 "Për familentin parashikon se: "Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim: a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit; b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin; c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për atë sa kjo periudhë është; ç) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë: i) vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes; ii) vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit; iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar; d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave; dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve; e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve; ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë; f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur. 2. Dokumentet, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë origjinale, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë...."

Gjykata vëren se kërkesa për fillimin e procedurës së falimentit është vendosur nga organi kompetent sikundër është Këshilli i administrimit të Shoqërisë.

Gjykata pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumenteve të sipërcituara bazuar në nenin 17 të ligjit "Per falimentin" me vendim të ndërmjetëm të datës 05.03.2019 i la 5 ditë kohë palës paditëse të plotësonte aktet dhe dokumentat në përputhje me nenin e sipërcituar. Pala paditëse mori dijeni mbi këtë vendim me dëftesë komunikimi në datë 18.03.2018 dhe plotësoi aktet sipas vendimit të ndërmjetëm të gjykatës.

Neni 17 i ligjit për falimentin parashikon se: "Nëse debitori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij

ligji. Në qoftë se, pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumenteve, vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e procedurës brenda 5 ditëve, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji.”

Gjykata referuar akteteve bashkangjitur kërkesës dhe atyre të paraqitura në plotësim të vendimit gjyqësor, nga një rishikim i përgjithshëm i dokumenteve si raporti i debitorit ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese; ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin; bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit, listën e pronave të luajtshme sepse prona të paluajtshme debitori nuk ka deklaruar, vlera e këtyre pasurive të luajtshme në momentin e blerjes dhe nga vlera e tij sipas bilanceve të llogaritura nga debitori është në vlerën 32925580 lekë, listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje në shumën 7.439.414 leke referuar deklaramit të debitorit dhe ekstraktit bankar, listës të kreditorëve dhe listës të debitorëve të debitorit, listës të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë paditëse si dhe faktit që aktiviteti i kesaj shoqërie është mbyllur në datë 31.12.2018 për shkak të ligjit 75/2018, çmon se për këtë debitor duhet të fillojë procedura e falimentit.

Situata financiare e shoqërisë si rezultat i mbylljes së aktivitetit ka sjelle pasoja me mbingarkesë të borxheve që ka pasi ajo nuk është në gjendje të tillë financiare që mund të kryej shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare që kanë afate maturimi të mevonshme. Gjykata vëren se kërkuesi në cilësinë e debitorit referuar listës së kreditorëve persona juridik ka detyrime ndaj kreditorëve si Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në masën 300.927.840 lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në masën 9.107.881 lekë, Neptun sh.p.k në masën 5.548.970 lekë dhe ortakët e shoqërisë në masën 219487933 lekë për të gjithë ortakët. Përveç kësaj ai ka detyrime dhe ndaj personave fizik punonjës së tij.

Krahas kesaj, paaftësia e saj paguese shtrihet edhe në një të ardhme të afert pasi shoqëria sikundër u citua më lart nuk ushtron më aktivitet për shkak të ligjit që ndalon këtë veprimtari.

Sa me sipër u parashtrua nga gjykata, rezultoi se nga pala kerkuese të gjitha keto akte formale detyruese u paraqiten si të tilla në formën dhe përmbajtjen e kerkuar nga ligji dhe gjykata bazuar në nenin 17 të ligjit 110/2016 çmon të deklarojë fillimin e procedurës së falimentit duke çmuar gjendjen e paaftësisë paguese të debitorit.

Sa me lart dhe në perfundim të hetimit gjyqësor, gjykata vendos pranimin e kërkesës dhe në datë 05.04.2019 të procedurës së falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a, e regjistruar në regjistrin tregëtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër NIUS K51313001H duke emeruar si administratore të falimentimit znj. Shpresa Breçani.

Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të nenit 29 pika 2 c), pika 4 të ligjit “Për falimentimin”, urdherohet :

- ✓ Botimin e një kopje të shkurtuar të këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit Shoqëria “ITSGA” sh.a, në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.
- ✓ një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a, t’i njoftohet debitorit, administratorit të falimentit.
- ✓ një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a administratori i falimentit t’ia komunikojë secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit.

Shpenzimet në lidhje me keto veprime proceduriale i ngarkohen masës së falimentimit.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenet 126, 306-308 të K. Pr. Civile, nenin 29 e vijues të ligjit 110/2016 “Për falimentimin”

VENDOSI :

1. Pranimin e kerkeses se kerkuesit, Shoqeria "ITSGA" sh.a.
2. Hapjen në datë 05.04.2019, te procedures se falimentimit te Shoqerise "ITSGA" sh.a me administrator z. Mateos Zoto, me veprimtari "organizim lojrash fati", me NUIS K51313001H dhe me seli në adresën Rruga e Dibrës, Pallat i ri 5- kate, kati i dytë, përbri Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tirane, Shqipëri.
3. Caktimin si administratore te falimentimit, per shoqerine "ITSGA" sh.a, te znj. Shpresa Breçani, e datëlindjes 20.03.1964, me nr. Personal G45320378H e liçensuar nga Ministria e Drejtësisë, me liçencen Nr. 09, date 16.10.2012, me NIPT K71529023K, me Adrese: Rruga Panorama (ish-rruga Jordan Misja), pall. Sara-El, kati i dytë pranë Hipotekes Tiranë dhe me Cel:0682094103.
4. Te gjithë kreditorët e Shoqerise "ITSGA" sh.a, te paraqesin pretendimet e tyre tek administratori i falimentimit, brenda 45 diteve nga publikimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
5. Cdo person fizik apo juridik i cili ka detyrime ndaj debitorit shoqëria "ITSGA" sh.a t'ia paguajne dhe shlyejne ato administratorit të falimentit.
6. Caktimin e një komiteti të përkohshëm të kreditorëve në përputhje me nenin 29 pika dh) të ligjit nr.110/20116 "Për falimentin", duke u caktuar si anëtarë të këtij komiteti Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë si kreditor të pasiguruar dhe si kreditor i preferuar punonjësi ndaj të cilit kërkuesi ka detyrimin më të lartë.
7. Mbledhja e raportimit do të mbahet në datë **20.06.2019 ora 10.00.**
8. Urdhërohet botimi i një kopje të shkurtuar të këtij vendimi per hapjen e procedurave te falimentimit te subjektit Shoqeria "ITSGA" sh.a, në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.
9. Ky vendim i njoftohet debitorit shoqëria "ITSGA" sh.a, administratores së falimentit znj.Shpresa Breçani.
10. Administratori i falimentit i komunikon një kopje të këtij vendimi të gjithë kreditorëve të njohur të shoqërisë "ITSGA" sh.a.
11. Administratori i falimentit është i detyruar të bëjë rregjistrimin e vendimit sipas nenit 32 të ligjit nr.110/2016 "Per falimentin" në të gjitha regjistrat publikë ose institucione te tjera financiare ku janë të rregjistruara pasuri ose të drejta të tjera të debitorit.
12. Administratori i falimentit do të shpërblehet sipas VKM-së nr.197 datë 13.04.2007 "Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe rimbursimit te shpenzimeve të administratorit të falimentit".
13. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kerkuesit.
14. Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim i veçante ne Gjykatën e Apelit Tirane, brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesërmyja e komunikimit të tij.

U shpall, sot me date 05.04.2019

Sekretare
Anjeza Nergjoni

Gjyqtare
Eneida Civici

Shpenzime gjyqësore
Taksë gjyqësore 200 Lekë
Sekretare
Anjeza Nergjoni

